



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TË DREJTËS PËR INFORMIM DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 2478 Prot

Tiranë, më 25/11/2024

REKOMANDIM

Nr. 30, datë 25/11/2024

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS TË AUTORITETIT PUBLIK IDENTITEK SH.A.

Në mbështetje të neneve 4, 6, 7, si dhe shkronja f) e nenit 9/1 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 80, datë 14.2.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”, rezulton se në datën 15.03.2023 është themeluar IdentiTek Sh.a., i cila ka për mision regjistrimin, prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike të shtetasve shqiptarë dhe/ose shtetasve të huaj me banim të përhershëm apo të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë.

Në pikën 1 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar përcaktohet se: “Autoritet publik” a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike”; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike”.

Për sa më sipër IdentiTek Sh.a. konsiderohet autoritet publik, në kuptim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar.

Autoritetet publike, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë, si dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Pikat 2 dhe 3 të nenit 4 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, përcaktojnë se:

“2. Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;

b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;

c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

3. Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik”.

Programi i Transparencës vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës autoriteti publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet pasurimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të tij.

Në nenin 6 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.*

Në zbatim të shkronjës c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 6 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020, “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar.

Urdhri nr. 187, datë 18.12.2020 është një akt nënligjor, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 224 datë 22.12.2020¹.

Gjithashtu, referuar shkronjës f) të nenit 9/1 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale: *“f) bën rekomandime për autoritetet publike lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës”.*

¹ <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/12/18/187/eac66214-1453-4b4f-878e-50d3118f702d;q=urdher%20187%20date%2018.12.2020>

Për sa më sipër, autoriteti publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën për Informim me Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Nga monitorimi i kryer në faqen zyrtare <https://identitek.al/> rezulton se Autoriteti Publik ka publikuar ikonën “Programi i Transparencës”, sipas modelit të Urdhrit nr.187, datë 18.12.2020, “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar. Por pjesa më e madhe e informacionit mbetet e papublikuar në këtë program.

Rezultoni i publikuar informacioni lidhur me funksionet dhe detyrat e Autoritetit Publik, adresa, orari për t’u informuar, formati i kërkesës, formati i ankesës, procedurat/mekanismat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP.

Bazuar në monitorimin e kryer, Zyra e Komisionerit konstaton mangësi në plotësimin e informacionit, në përputhje me pikën 1 të nenit 7, të LDI, si dhe Urdhrit të Komisionerit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, konkretisht në rubrikat e mëposhtme:

➤ **Rreth Autoritetit**

- Struktura organizative/Organigrama
- Struktura e pagave;
- CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre;
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime;

➤ **Kuadri ligjor rregullator**

- Legjislacioni ndërkombëtar
- Legjislacioni kombëtar
- Akte nënligjore
- Rregullore;
- Kodi i sjelljes;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit;
- Strategji;
- Raport vjetor;
- Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun.

➤ **E drejta për tu informuar**

- Koordinator / Emri mbiemri
- E-mail
- Nr. i gjelbër/ Tel

➤ **Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi autoritetin publik**

- Planet strategjike të punës;
- Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së AP

➤ **Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të autoritetit publik**

- Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara;
- Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset;
- Donacione, sponsorizime;
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

➤ **Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik/privat**

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve);
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik;
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik;
- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

➤ **Shërbimet që ofrohen nga autoriteti publik**

- Lista e Shërbimeve që ofron AP, përfshirë:
- tarifatat përkatëse (nëse ka);
- formular aplikimi;
- afati kohor;
- procedurë ankimimi;
- standardet për cilësinë e shërbimit.

➤ **Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve**

- Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes;

- Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto).
- **Rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve**
- Rregjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve, i përditësuar (sipas Modelit të Rregjistrit të miratuar nga Komisioneri).
- **Ndihma shoqërore/subvencionet të dhëna nga autoriteti publik**
- Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve;
- Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim;
- Procedura e ankimimit.
- **Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun nga autoriteti publik**
- Njoftime të ndryshme;
- Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimimit në shërbim civil;
- Raporte;
- Publikime;
- Statistika;
- Projekte;
- Bashkëpunime etj.

**Shënim: Nëse Autoriteti Publik nuk disponon informacionin, të vendoset shënimimi (nuk ka informacion) në krahasim të çdo pike.*

Informacioni duhet të publikohet i përditësuar, në çdo rast që pëson ndryshime, duke shënuar edhe datën e përditësimit të fundit.

Autoriteti publik rekomandohet të përfshijë në programin e transparencës gjithashtu vendime të rëndësishme të tij, udhëzime të përgjithshme të detyrueshme, si dhe çdo informacion që çmohet i dobishëm për qytetarët.

Për lehtësinë tuaj, Programin Model të Transparencës, po jua bashkëlidhim këtij rekomandimi me CD. Gjithashtu bëjmë me dije se Zyra e Komisionerit ka hartuar udhëzime/rekomandime lidhur me vënien në zbatim të programit institucional të transparencës dhe mbetet në dispozicion të autoriteteve publike, mbi nevojat e tyre për paqartësi/informacion/rritje kapacitetesh, lidhur me zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit.

Me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoritetet publike kanë detyrimin ligjor të caktojnë një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Pika 1 e nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” i

ndryshuar, përcakton se: *“1. Titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, titullari i autoritetit publik i njofton Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit”*.

Koordinatori për të drejtën e informimit ka detyrimin e ushtrimit të kompetencave të parashikuara në pikën 2 të nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar, ku ndër të tjera është përgjegjës për bashkërendimin e punës për trajtimin e kërkesave për informacion të qytetarëve, si dhe për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Në pikën 1 të nenit 8 të Ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”* i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër”*.

Pika 2 e nenit 8 të Ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”* i ndryshuar, parashikon se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit”*.

Në zbatim të përcaktimit ligjor më sipër, Komisioneri ka miratuar formatin dhe përmbajtjen e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve me Urdhërin nr. 188/2020 *“Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”*.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi Model i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve përfaqësojnë instrumentet kryesore të promovimit të transparencës së autoriteteve publike dhe garantimit të së drejtës për informim të publikut dhe çdo autoritet publik është i detyruar ligjërisht ti vërë në zbatim.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 6, 7, 8, shkronjës f) të nenit 9/1, si dhe shkronjës b) të pikës 2 të nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”* i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik IdentiTek Sh.a., të përditësojë, ndërlihdë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike, në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i

ndryshuar, Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe këtij Rekomandimi brenda një afati 90 ditë nga momenti i marrjes dijeni të tij.

2. Titullari i Autoritetit Publik IdentiTek Sh.a., të caktojë një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit dhe menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, t’i njoftojë Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit, në përputhje me pikën 1, të nenit 10, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Koordinatori për të drejtën për informim pranë Autoritetit Publik IdentiTek Sh.a., të krijojë, mbajë, bëjë publik dhe përditësojë Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, në përmbushje të detyrimeve të shkronjës b), të pikës 2, të nenit 10 dhe në zbatim të pikës 1, të nenit 8 ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar dhe sipas Urdhërit nr. 188/2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”.
4. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas neneve 18 dhe 19 të Ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 25.11.2024 dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

IDENTITEK SH.A.

Raport i monitorimit për zbatimin e programit institucional të transparencës, bazuar në Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Autoritetin Publik “IdentiTek sh.a”.

Ky raport monitorimi merr në konsideratë vetëm publikimin e informacioneve të cilat janë të ndërlidhura me programin e transparencës sipas Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”.

1	Rreth Autoritetit	Rezultatet	Koment
	Struktura organizative/Organigrama	Jo	
	Struktura e pagave	Jo	
	Funksionet dhe detyrat e AP	Po	
	CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre dhe procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime.	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime.	Pjesërisht	Ka informacion pjesërisht por jo procedurën konkrete.
	Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e AP (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve).	Pjesërisht	Mungon formulari i kërkesës, ankesës, afatet për mënyrën e kthimit të përgjigjeve.
2	Kuadri ligjor rregullator		
	Legjislacion ndërkombëtar	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Legjislacion kombëtar	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Akte nënligjore	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Rregullore	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Kodi i sjelljes	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo	Jo	Është si rubrikë

	kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit		por nuk ka informacion.
	Strategji	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Raport vjetor	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
3	E drejta për tu informuar		
	Koordinatori / Emri mbiemri	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	E-mail	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Nr. i gjelbër/ Tel	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Adresa:	Po	
	Orari:	Po	
	Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)	Po	
	Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)	Po	
4	Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP		
	Rezolute Kuvendi nëse ka të tillë	-	Nuk është si rubrikë
	Planet strategjike të punës	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Raporte monitorimi/auditimi psh KLSH	-	Nuk është si rubrikë
	Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së AP	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
5	Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna financiare të autoritetit publik		
	Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (sipas viteve)	Pjesërisht	Mungon plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara.
	Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve)	Jo	Është si rubrikë por nuk ka

			informacion.
	Donacione, sponsorizime (sipas viteve)	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
6	Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat		
	Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)	-	Është vendosur shënimi: nuk ka informacion
	Regjistri i realizimeve të prokurimit publik	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Informacion mbi monitorimin e kontratave	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i përditësuar	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
7	Shërbimet që ofrohen nga AP		
	Lista e Shërbimeve të AP dhe tarifat përkatëse (nëse ka)	Po	
	Formular aplikimi	Jo	Është vendosur linku por nuk është i disponueshëm.
	Afati kohor	Jo	Nuk është si rubrikë
	Procedura ankimimi	Jo	Nuk është si rubrikë
	Standartet për cilësinë e shërbimit	Jo	Nuk është si rubrikë
8	Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP		
	Njoftimi dhe konsultimi publik (Linku)	-	*IdentiTek nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore.
	Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi	Jo	*IdentiTek nuk ka iniciativë për propozimin e

			akteve ligjore.
	Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve	Jo	*IdentiTek nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore.
	Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Jo	*IdentiTek nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore.
	Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP	Jo	*IdentiTek nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore.
	Emër mbiemër koordinatori për konsultimin me publikun, adresë postare /elektronike	Jo	*IdentiTek nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore.
9	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve		
	Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
10	Rregjistri i kërkesave dhe Përgjigjeve		
	Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri)	Jo	Është tabela e Regjistrit por nuk ka informacion.
11	Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP		
	Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP	-	IdentiTek nuk jep ndihma shoqërore apo subvencione.
	Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve	Jo	Nuk është si rubrikë
	Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim	Jo	Nuk është si rubrikë
	Procedura e ankimimit	Jo	Nuk është si rubrikë
12	Informacion/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun		
	Njoftime të ndryshme	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil	Jo	Është si rubrikë por nuk ka

			informacion.
	Raporte	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Publikime	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Statistika	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Projekte	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.
	Bashkëpunime etj.	Jo	Është si rubrikë por nuk ka informacion.

IDENTITEK SH.A.

Programi i Transparencës | Identitek

Identitek/programi-i-transparencës

Kreu Identitek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar shoqëria "Identitek" SH.A ka krijuar programin e transparencës, ku në përputhje me objektin e veprimtarisë garanton njohjen maksimale të informacionit publik.

Programi i Transparencës

Hyrje

- Rreth autoritetit
- Kuadri ligjor rregullator
- E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
- Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që vepronin mbi Identitek
- Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të Identitek
- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/PPP
- Shërbimet që ofrohen nga Identitek
- Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nenligjore, politkave publike apo në lidhje me shtresimin e funksioneve të "Identitek" SH.A
- Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
- Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga Identitek SH.A
- Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykojnë të dobishme për publikim nga Identitek

Programi i Transparencës | Identitek

Identitek/programi-i-transparencës

Kreu Identitek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Struktura organizative/Organigrama

Në zbatim të vendimit nr 80, datë 14.02.2023, të Këshillit të Ministrave, "Mbi krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike", me 15.3.2023 është themeluar shoqëria "Identitek" SH.A. Shoqëria "Identitek" SH.A funksionon sipas strukturës së miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Struktura e Pagave

Funksionet dhe detyrat e "Identitek" SH.A "Identitek" SH.A është shoqëria përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike të identifikimit për shtetasit shqiptarë. Shoqëria vepron në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të "Identitek" SH.A, përkshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre.

Procedura që ndjekin funksionaret e lartë të "Identitek" SH.A për të marrë vendime.

"Identitek" është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, e zotëruar nga Ministria e Brendshme.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga legjislati në fuqi dhe statuti i saj.

Shoqëria organizohet sipas sistemit të drejtimit me dy nivele.

Organet drejtuese të shoqërisë "Identitek" janë

Asambleja e Përgjithshme (Aksionari), i cili është organi më i lartë vendimmarrës në shoqëri.

Këshilli Mbiqëqyrës i cili përbehet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme:

- Andi Mahila – Kryetar
- Etugert Llazi – Anëtar
- Marbona Cuka – Anëtar
- Jonida Gaba – Anëtar
- Donika Hoxha – Anëtar

Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe është i ngarkuar me administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë

Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet dhe mosveprimet e "Identitek".

Për çdo paqartësi, kërkesë apo ankesë, çdo i interesuar mund t'i drejtohet shoqërisë "Identitek" SH.A:

- në rrugë shkrese, në adresën Rruga "Xhanfize Keko", Tiranë
- nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@identitek.aii
- duke kontaktuar koordinatorin për të drejtën e informimit në postën elektronike

Programi i Transparencës | IdentTek | Panja e dokumentit - Qendra

identtek.al/programi-i-transparencës

Kreu IdentTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Veptrimaria e shoqërisë rregullohet nga legjislati në fuqi dhe statuti i saj.
Shoqëria organizohet sipas sistemit të drejtimit me dy nivele.
[Organet drejtuese të shoqërisë "IdentTek" janë](#)

Asambleja e Përgjithshme (Aksionari), i cili është organi më i lartë vendimarrës në shoqëri.
Keshilli Mbeqkyrës, i cili përbëhet nga 5 (pese) anëtarë, të cilet emërohen nga Asambleja e Përgjithshme:
- Andi Mahila – Kryetar
- Etugert Llaz – Anëtar
- Marbona Cuka – Anëtar
- Jonida Gaba – Anëtar
- Donika Hoxha – Anëtar

Administratori, emërohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe është i ngarkuar me administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë.
[Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankese që lidhen me veprimet dhe mosveprimet e "IdentTek"](#).

Për çdo paqartësi, kërkesë apo ankese, çdo i interesuar mund t'i drejtohet shoqërisë "IdentTek" SHA:
- në rrugë shkrese, në adresën Rruga "Xhanfze Keko", Tiranë
- nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@identtek.al
- duke kontaktuar koordinatorin për të drejtën e informimit në postën elektronike

[Funksionet dhe detyrat e "IdentTek" SHA](#)

"IdentTek" SHA është shoqëria përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike të identifikimit për shtetasit shqiptarë.
Shoqëria vepron në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në RSH.
CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të "IdentTek" SHA, përkshirë të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre.
Procedura që ndjekin funksionet e lartë të "IdentTek" SHA për të marrë vendime
Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankese që lidhen me veprimet dhe mosveprimet e "IdentTek".
Për çdo paqartësi, kërkesë apo ankese, çdo i interesuar mund t'i drejtohet shoqërisë "IdentTek" SHA:
- në rrugë shkrese, në adresën Rruga "Xhanfze Keko", Tiranë
- nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@identtek.al
- duke kontaktuar koordinatorin për të drejtën e informimit në postën elektronike

Mekanizmat kontrollues | Informacion mbi buxhetin | Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të

Programi i Transparencës | IdentTek | rezervo.identtek.al | Panja e dokumentit - Qendra

identtek.al/programi-i-transparencës

Kreu IdentTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar shoqëria "IdentTek" SHA ka krijuar programin e transparencës, ku në përputhje me objektin e veprimitarisë garanton njohjen maksimale të informacionit publik.

Programi i Transparencës
Hyrje

Rreth autoritetit | Kuadri ligjor rregullator | E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar

Legjisllacion ndërkombëtar
Legjisllacion kombëtar
Ligje
Akte nënligjore (VKM, Udhëzime, etj.)
Kodi i sjelljes
Regullore
Strategji
Raport vjetor
Manuale/dokument politikash që ka lidhje me funksionet e "IdentTek" SHA dhe që prek publikun

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi IdentTek | Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të IdentTek | Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/PPP

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave | Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe

Programi i Transparencës | IdentTek | rezervo.identitek.al | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | +

identitek.al/programi-i-transparencës

identitek

Kreu IdentTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Programi i Transparencës

Hyrje

Rreth autoritetit Kuadri ligjor rregullator E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar

Ne zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Autoriteti Publik cakton një prej nëpunëve si Koordinator për të drejtën e informimit, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e të drejtës së informimit. Koordinator për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e mëposhtme:

- i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin original ose duke marrë një kopje të tij; - krijon, mban, publikon dhe përditëson; - krijon, mban, publikon dhe përditëson
- bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afatave dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligji;
- regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilin prej tyre;
- dërgon kërkesën për informim të një Autoritet tjetër Publik, brenda afatave të parashikuara në këtë ligji, kur rezultoni se Autoriteti Publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;
- verifikon rastet për dhënie falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 13 të këtij ligji;
- kryen njoftimet paraprake, sipas neneve 14 dhe 15, të këtij ligji, si dhe komunikim me kërkuenin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.
- Koordinator/ Emri mbiemri:
- E-mail:
- Nr. Tel:
- E hënë - E premte: 8.30 - 17.30
- Adresa: Rruga "Xhanfize Keko", Tiranë
- Orari: E hënë- E premte 08.30 - 17.30
- Format kërkesë për informacion
- Format ankese drejtuar Komisionit

Informacion për procedurat e

Type here to search 17°C Mostly sunny 12:30 PM 11/11/2024

Programi i Transparencës | IdentTek | rezervo.identitek.al | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | +

identitek.al/programi-i-transparencës

identitek

Kreu IdentTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Programi i Transparencës

Hyrje

Rreth autoritetit Kuadri ligjor rregullator E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi IdentTek Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të IdentTek Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/PPP

Plane Strategjike të Punës
Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së "IdentTek" SHA.

Shërbimet që ofrohen nga IdentTek Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nenligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të "IdentTek" SHA Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga IdentTek SHA Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga IdentTek

Type here to search 17°C Mostly sunny 12:31 PM 11/11/2024

Programi i Transparencës | IdentiTek | rezervo.identitek.al | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | +

identitek.al/programi-i-transparencës

identitek

Kreu IdentiTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

[Una monitorues që veprojë mbi IdentiTek](#)
[Una të dhëna financiare të IdentiTek](#)
[koncesionit/PPP](#)

Shoqëria IdentiTek sh.a u krijua sipas Vendim Nr. 80, datë 14.02.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike", me kapital 100 (njëqind) % shtetëror me vlerë kapitali fillestar 20,000,000 lekë. Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar është Ministria e Brendshme.

Aktiviteti i shoqërisë është ofrimi kundrejt pagesës për shërbimin e prodhimit dhe shpërndarjes së:

- Letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike
- Lejeve të qëndrimit
- Letërnjoftimit elektronik dhe dokumenteve të udhëtimit për personat që kanë përftuar statusin e refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese

Tarifat e shërbimeve përcaktohen me Udhëzimin të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 100, datë 2007.2023 "Për përcaktimin e tarifave për pajisjen e shtetasve shqiptarë dhe të huaj me dokumente biometrike". Shoqëria financohet nga të ardhurat e veta nga ofrimi i shërbimeve dhe burimeve të tjera të ligjshme.

Për vitin 2023
 Te Ardhurat e parashikuara **1,897,567,937 Lekë**
 Te Ardhurat e realizuara **1,588,695,896 Lekë**
 Realizimi në % **84.80%**

Për vitin 2024
 Te Ardhurat e parashikuara **3,499,280,965 Lekë**
 Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara
 Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset
 Donacione, sponsorizime
 Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara

[Shërbimet që ofrohen nga IdentiTek](#)
[Procedurat/mekanizmat për të dhëna mendime lidhur me procedurën e hartimit të akteve ligjore/njoftimeve, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të "IdentiTek" SHA](#)
[Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve](#)

17°C Mostly sunny 12:32 PM 11/11/2024

Programi i Transparencës | IdentiTek | rezervo.identitek.al | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | +

identitek.al/programi-i-transparencës

identitek

Kreu IdentiTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

[Rreth autoritetit](#)
[Kuaiidri ligjor rregullator](#)
[E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar](#)


[Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojë mbi IdentiTek](#)
[Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna financiare të IdentiTek](#)
[Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/PPP](#)

Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palet kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)
 Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik
 Regjistri i realizimeve dhe donacionet (sipas viteve)
 Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave si dhe udhëzues të politikave të ndryshme *
 * IdentiTek nuk ka informacion

[Shërbimet që ofrohen nga IdentiTek](#)
[Procedurat/mekanizmat për të dhëna mendime lidhur me procedurën e hartimit të akteve ligjore/njoftimeve, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të "IdentiTek" SHA](#)
[Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve](#)

[Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve](#)
[Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga IdentiTek SHA](#)
[Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga IdentiTek](#)

17°C Mostly sunny 12:32 PM 11/11/2024



IdentiTek

**Shërbimi i rezervimit përkohësisht i padisponueshëm.
Aplikimet vazhdojnë normalisht pranë zyrave tona.**



Programi i Transparencës | IdentiTek | rezervo.identitek.al

identitek.al/programi-i-transparencës

Kreu IdentiTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Njoftime

- Rreth autoritetit
- Kuadri ligjor rregullator
- E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
- Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi IdentiTek
- Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të IdentiTek
- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/PPP
- Shërbimet që ofrohen nga IdentiTek
- Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nëligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të IdentiTek ShA
- Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

Njoftimi dhe konsultimi publik (IdentiTek nuk e ofron këtë shërbim)
 Komente/Rekomandime/Opinionet e paleve të interesuara/grupe të interesit *
 Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve *
 Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes *
 Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike IdentiTek, ushtrimin e funksioneve të IdentiTek
 Emër mbiemri të koordinatorit për konsultimin publik, adresë postare/elektronike *
 * IdentiTek nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore

- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
- Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga IdentiTek ShA
- Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga IdentiTek

17°C Mostly sunny 12:33 PM 11/11/2024

Programi i Transparencës | IdentiTek | rezervo.identitek.al

identitek.al/programi-i-transparencës

Kreu IdentiTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Njoftime

- Rreth autoritetit
- Kuadri ligjor rregullator
- E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
- Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi IdentiTek
- Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të IdentiTek
- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/PPP
- Shërbimet që ofrohen nga IdentiTek
- Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nëligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të IdentiTek ShA
- Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

Lista e dokumenteve që administrohen nga IdentiTek me afatet e ruajtjes (lista e dokumenteve të prodhuara nga shoqëria)
 Formën e dokumenteve/informacioneve

- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
- Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga IdentiTek ShA
- Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga IdentiTek

17°C Mostly sunny 12:34 PM 11/11/2024

Programi i Transparencës | IdentTek | rezervo.identitek.al | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra

identitek.al/programi-i-transparencës

identitek

Kreu IdentTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar shoqëria "IdentTek" SHA ka krijuar programin e transparencës, ku në përputhje me objektin e veprimtarisë garanton njohjen maksimale të informacionit publik.

Programi i Transparencës

Hyrje

Rreth autoritetit	Kuadri ligjor rregullator	E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi IdentTek	Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të IdentTek	Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/PPP
Shërbimet që ofrohen nga IdentTek	Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të aktave ligjore/neiligjore, politikeve publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të IdentTek SHA	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga IdentTek SHA	Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga IdentTek

* IdentTek SHA nuk jep ndihma shoqërore dhe subvencione

17°C Mostly sunny 12:38 PM 11/11/2024

Programi i Transparencës | IdentTek | rezervo.identitek.al | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra | Panja e dokumentit - Qendra

identitek.al/programi-i-transparencës

identitek

Kreu IdentTek Dokumente Biometrike Procedurat e Aplikimit Njoftime Karriera Programi i Transparencës Kontakt

Programi i Transparencës

Hyrje

Rreth autoritetit	Kuadri ligjor rregullator	E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi IdentTek	Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të IdentTek	Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/PPP
Shërbimet që ofrohen nga IdentTek	Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të aktave ligjore/neiligjore, politikeve publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të IdentTek SHA	Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga IdentTek SHA	Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga IdentTek

Njoftime të ndryshme

- Njoftime për procedurat e rekrutimit
- Raporte
- Publikime
- Statistika
- Projekte
- Bashkëpunime etj.

Shënim: IdentTek vlerëson publikimin duke patur parasysh kërkesat që merr më shpesh.

17°C Mostly sunny 12:38 PM 11/11/2024